



Aktuatorët pneumatikë Tipi 3271 dhe Tipi 3277



Sipërfaqja e aktuatorit: 240, 350 dhe 700 cm²



Tipi 3271



Tipi 3277

Përkthim i udhëzimeve origjinale

Udhëzimet e montimit dhe operimit

EB 8310-6 SQ

Edicioni Mars 2017

Shënime mbi këto udhëzime montimi dhe operimi

Këto udhëzime montimi dhe operimi ju ndihmojnë në montimin dhe operimin e pajisjes në mënyrë të sigurt. Udhëzimet janë të detyrueshme për trajtimin e pajisjeve SAMSON.

- Për përdorimin e sigurt dhe të mirë të këtyre udhëzimeve, lexojini me kujdes dhe ruajini për referencë në të ardhmen.
- Nëse keni pyetje rreth këtyre udhëzimeve, kontaktoni departamentin e pas shitjes të SAMSON (aftersaleservice@samson.de).



Udhëzimet për montimin dhe operimin janë përfshirë në dërgesë. Dokumentacioni më i fundit është i disponueshëm në faqen tonë të internetit (www.samson.de) Product documentation. Mund të vendosni numrin e dokumentit ose të shkruani numrin në fushën [Find:] për të kërkuar një dokument.

Përkufizimi i fjalëve të sinjaleve

RREZIK!

Situata të cilat, nëse nuk shmangen, do të çojnë në vdekje ose lëndime serioze

PARALAJMËRIM!

Situata të rrezikshme të cilat, nëse nuk shmangen, mund të çojnë në vdekje ose lëndime serioze

NJOFTIM

Mesazh për dëmtim të pronës ose defekt

Shënim

Informacione shtesë

Këshillë

Veprimi i rekomanduar

1	Udhëzimet dhe masat e sigurisë.....	5
1.1	Shënime mbi lëndimet e mundshme të rënda.....	7
1.2	Shënime mbi lëndimet e mundshme.....	8
1.3	Shënime mbi dëmtimet e mundshme të pronës.....	9
2	Shënimet në pajisje	10
2.1	Etiketa e të dhënave të aktuatorit	10
3	Ndërtimi dhe parimi i operimit.....	11
3.1	Tipi 3271	11
3.2	Tipi 3277	12
3.3	Drejtimi i veprimit	13
3.4	Rruga e presionit të sinjalit.....	13
3.4.1	Tipi 3271	13
3.4.2	Tipi 3277	13
3.5	Veprimi i sigurt	13
3.5.1	Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit zgjatet" (FA)	14
3.5.2	Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit tërhiqet" (FE).....	14
3.6	Versionet.....	14
3.7	Të dhëna teknike	15
4	Masat për përgatitjen	19
4.1	Shpaketimi	19
4.2	Transporti dhe ngritja	19
4.2.1	Transporti	20
4.2.2	Ngritja	20
4.3	Ruajtja	22
4.4	Përgatitja për instalimin	23
5	Montimi dhe vënia në punë	24
5.1	Montimi i aktuatorit në valvul	24
5.2	Shtypja e sustave	27
5.2.1	Shtërëngimi i sustave	27
5.2.2	Rritja e shtytjes së aktuatorit.....	27
5.2.3	Përshtatja e diapazonit të lëvizjes.....	28

6	Operimi	30
6.1	Shërbimi i mbylljes	30
6.2	Shërbimi on/off	30
6.3	Kthimi i drejtimit të veprimit	31
6.3.1	Kthimi i drejtimit të veprimit nga boshti zgjatet në boshti tërhiqet	31
6.3.2	Kthimi i drejtimit të veprimit nga boshti tërhiqet në boshti zgjatet	33
6.4	Versioni me volant	35
6.4.1	Zgjatja manualisht e boshtit të aktuatorit	35
6.4.2	Tërheqja manualisht e boshtit të aktuatorit	35
6.5	Rregullimi i ndalesës së lëvizjes	36
6.5.1	Ndalesa e poshtme e lëvizjes (lëvizja minimale)	36
6.5.2	Ndalesa e sipërme e lëvizjes (lëvizja maksimale)	36
7	Shërbimi	38
7.1	Ndërrimi i diafragmës	39
7.2	Ndërrimi i gominave të boshtit të aktuatorit	42
7.3	Përgatitja për dërgesën e kthimit	44
7.4	Porositja e pjesëve të këmbimit dhe furnizimeve të operimit	45
8	Defektet	46
9	Heqja nga puna dhe çmontimi	48
9.1	Heqja nga puna	48
9.2	Heqja e aktuatorit nga valvula	48
9.3	Lirimi i kompresionit të sustës në aktuator	48
9.4	Hedhja	48
10	Shtojcë	50
10.1	Shërbimi pas shitjes	50
10.2	Pjesët e këmbimit	51

1 Udhëzimet dhe masat e sigurisë

Përdorimi i synuar

Aktuatorët SAMSON tipi 3271 dhe 3277 janë bërë për të operuar një valvul glob të montuar. Në kombinim me valvulën, aktuatorët përdoren për të mbyllur rrjedhën e lëngjeve, gazrave ose avujve në tubacion. Në varësi të versionit, aktuatorët janë të përshtatshëm për të mbylljen ose shërbimin on/off. Aktuatorët mund të përdoren në impiante përpunimi dhe industriale.

Aktuatorët janë bërë për të operuar në kushte të përcaktuara saktë (p.sh. shtytje, udhëtim). Prandaj, operatorët duhet të sigurohen që aktuatorët të përdoren vetëm në aplikime që plotësojnë specifikimet e përdorura për zgjedhjen madhësisë së aktuatorëve në fazën e porosities. Në rast se operatorët synojnë t'i përdorin aktuatorët në aplikime ose kushte të tjera përveç atyre të përcaktuara, kontaktoni SAMSON.

SAMSON nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtimet që vijnë nga mospërdorimi i valvulës për qëllimin e synuar ose për dëmtimet e shkaktuara nga forcat e jashtme ose ndonjë faktor tjetër i jashtëm.

→ Shikoni të dhënat teknike dhe etiketën e të dhënave për limitet dhe fushat e aplikimit si edhe përdorimet e mundshme.

Keqpërdorimi i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme

Aktuatori nuk është i përshtatshëm për aplikimet e mëposhtme:

- Përdorimi jashtë kufijve të përcaktuar gjatë zgjedhjes së madhësisë dhe në të dhënat teknike
- Përdorimi jashtë kufijve të përcaktuar nga aksesoret e montuar në aktuator

Për më tepër, aktivitetet e mëposhtme nuk përputhen me përdorimin e synuar:

- Përdorimi i pjesëve të këmbimit jo-orijinale
- Bërja e punëve të shërbimit dhe riparimit që nuk janë përshkruar në këto udhëzime

Kualifikimet e personelit të operimit

Aktuatori duhet të montohet, vihet në punë, shërbehet dhe riparohet vetëm nga personeli i trajnuar dhe kualifikuar plotësisht; duhet të zbatohen kodet dhe praktikrat e pranura të industrisë. Sipas këtyre udhëzimeve të montimit dhe operimit, personeli i trajnuar i referohet individëve të cilët janë në gjendje të gjykojnë punën që u është caktuar dhe të dallojnë rreziqet e mundshme në sajë të trajnimit të tyre të specializuar, njohurisë dhe përvojës së tyre, si edhe njohurisë për standardet që zbatohen.

Pajisjet personale mbrojtëse

Rekomandojmë që të vishni mjetet personale mbrojtëse kur merreni me aktuatorët pneumatikë të tipit 3271 dhe tipit 3277:

- Doreza mbrojtëse kur montoni ose hiqni aktuatorin

➔ Konsultohuni me operatorin e impiantit për detaje mbi mjete mbrojtëse të mëtejshme.

Rishikimet dhe modifikimet e tjera

Rishikimet, konfertimet ose modifikimet e tjera në produkt nuk janë të autorizuar nga SAMSON. Ato bëhen me rrezikun e vetë përdoruesit dhe mund të çojnë në rreziqe sigurie, për shembull. Për më tepër, produkti mund të mos përbushë më kërkesat për përdorimin e synuar të tij.

Mjetet e sigurisë

Aktuatorët e tipit 3271 dhe tipit 3277 nuk kanë pajisje të veçanta sigurie.

Paralajmërimet kundër rreziqeve të mbetura

Përtë shmangur lëndimet personale ose dëmtimet e pronës, operatorët e impiantit dhe personeli i operimit duhet të parandalojë rreziqet që mund të shkaktohen në aktuator nga materiali i procesit, presioni i operimit, presioni i sinjalit ose nga pjesët lëvizëse duke marrë masat paraprake të përshtatshme. Ata duhet të mbajnë parasysh të gjitha deklaratat për rreziqet, paralajmërimet dhe shënimet për të pasur kujdes në këto udhëzime montimi dhe operimi, sidomos për instalimin, vënien në punë dhe punën e shërbimit.

Përgjegjësitë e operatorit

Operatori është përgjegjës për operimin e duhur dhe zbatimin e rregullave të sigurisë. Operatorët janë të detyruar t'ia sigurojnë këto udhëzime montimi dhe operimi si edhe dokumentet e referuara personelit të operimit dhe t'i udhëzojnë për përdorimin e duhur. Për më tepër, operatori duhet të sigurohet që personeli i operimit ose personat e tretë të mos ekspozohen ndaj asnjë rreziku.

Përgjegjësitë e personelit të operimit

Personeli i operimit duhet të lexojë dhe kuptojë këto udhëzime montimi dhe operimi si edhe dokumentet e referuara dhe të zbatojë deklaratat e sigurisë, paralajmërimet dhe shënimet për kujdes të specifikuar në to. Për më tepër, personeli i operimit duhet të njihet me rregullat që zbatohen për shënëdetin, sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve dhe t'i përmbahet atyre.

Standardet dhe rregulloret e referuara

Sipas vlerësimit të rrezikut për ndezjen të bërë sipas EN 13463-1:2009, pjesa 5.2, aktuatorët jo-elektrikë nuk kanë burimin e tyre të ndezjes së mundshme edhe në rastin e rrallë të një defekti në operim. Si rezultat, ato nuk bien brenda shtrirjes së direktivës 2014/34/EU.

→ Për lidhjen me një sistem lidhjeje ekuopotencial, zbatoni kërkesat e specifikuara në pjesën 6.4 të EN 60079-14 (VDE 0165 Pjesa 1).

Dokumentacioni i referuar

Përveç këtyre udhëzimeve për montimin dhe operimin, zbatohen edhe dokumentet e mëposhtme:

- Udhëzimet e montimit dhe operimit për valvulën e montuar
- Udhëzimet e montimit dhe operimit për aksesorët e valvulës së montuar (pozicionuesi, valvula solenoid, etj.)
- Manuali i sigurisë ► SH 8310 për përdorim në sistemet me instrumente sigurie
- ► AB 0100 për mjetet, forcat e shtrëngimit dhe lubrifikantin

1.1 Shënime mbi lëndimet e mundshme të rënda

RREZIK

Rrezik i plasjes së aktuatorëve.

Aktuatorët janë në presion. Hapja e papërshtatshme mund të bëjë që komponentët e aktuatorit të plasin.

→ Para se të filloni punë në aktuator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të aktuatorit.

1.2 Shënime mbi lëndimet e mundshme

PARALAJMËRIM

Rrezik shtypjeje që lind nga pjesët lëvizëse

Aktuatori përmban pjesë lëvizëse (boshti i aktuatorit) i cili mund të lëndojë duart ose gishtat nëse futen në aktuator.

- Mos futni duart ose gishtat në skelet kur valvula është në punë.
- Kur punoni në aktuator, shkëputni dhe mbyllni furnizimin e ajrit pneumatik si edhe sinjalin e kontrollit.

Rrezik lëndimi personal kur aktuatori shfryhet

Ndërkohë që valvula është në punë, aktuatori mund të shfryhet gjatë kontrollit në qark të mbyllur ose kur valvula hapet dhe mbyllet.

- Instaloni valvulën e kontrollit në mënyrë të tillë që aktuatori të mos shfryjë në lartësinë e syrit.
- Përdorni silenciatorë dhe tapa shfryrjeje të përshtatshme.
- Vishni mbrojtëse për sytë kur punoni shumë afër valvulës së kontrollit.

Rrezik lëndimi personal për shkak të sustave në tension.

Aktuatorët me susta janë nën tension. Ato mund të identifikohen me bulonat e gjatë që dalin nga fundi i aktuatorit.

- Para se të filloni punë në aktuator, lironi kompresionin nga sustat (shiko pjesën 9.3).

Dëmtim për shëndetin sipas rregullores REACH.

Nëse pajisja SAMSON përmban një substancë e cila nuk është renditur si substancë me nivel të lartë shqetësimi në listën e kandidatëve të rregullores REACH, kjo rrethanë është treguar në shënimin e dërgesës së SAMSON.

- Informacione mbi përdorimin e sigurt të pjesës së prekur, shiko ► <http://www.samson.de/reach-en.html>.

1.3 Shënime mbi dëmtimet e mundshme të pronës

! NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të rripave të lidhur jo mirë.

→ Mos i lidhni rripat mbajtës në volant ose ndalesën e lëvizjes.

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të forcave të shtrëngimit tepër të larta ose tepër të ulëta.

Mbani parasysh forcat e specifikuar gjatë shtrëngimit të komponentëve të aktuatorit. Forcat e shtrëngimit tepër të larta bëjnë që pjesët të konsumohen më shpejt. Pjesët që nuk janë shtrënguar mirë mund të lirohen.

→ Mbani parasysh forcat e specifikuar të shtrëngimit (► AB 0100).

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të përdorimit të pjesëve të papërshtatshme.

Nevojiten mjete të caktuara për të punuar në aktuator.

→ Përdorni vetëm mjete të aprovuara nga SAMSON (► AB 0100).

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të përdorimit të lubrifikantëve të papërshtatshëm.

Lubrifikantët që duhen përdorur varen nga materiali i aktuatorit. Lubrifikantët e papërshtatshëm mund të gërryejnë dhe të dëmtojnë sipërfaqen e valvulës.

→ Përdorni vetëm lubrifikantë të aprovuar nga SAMSON (► AB 0100).

2 Shënimet në pajisje

2.1 Etiketa e të dhënave të aktuatorit

Etiketa e të dhënave është ngjitur në kasën e diafragmës. Përfshin të gjitha detajet e nevojshme për të identifikuar pajisjen.

- 2 ID e konfigurimit
- 3 Numri i serisë
- 4 Sipërfaqja e aktuatorit
- 5 Gama e punimit në bar
- 6 Gama e punimit në psi
- 7 Lëvizja e operimit në mm
- 8 Gama e oprimit në bar
- 9 Gama e operimit në psi
- 10 Presioni i lejuar i furnizimit $p_{\max}$ në bar
- 11 Presioni i lejuar i furnizimit $p_{\max}$ në psi
- 12 Simboli që tregon veprimin e sigurt



Boshti i aktuatorit zgjatet (FA)



Boshti i aktuatorit tërhiqet (FE)



Mbishkelje manuale

- 14 Fileta e lidhjes
- 15 Materiali i diafragmës
- 16 Data e prodhimit




Fig. 1: Etiketa e të dhënave e aktuatorit të tipit 3271


3 Ndërtimi dhe parimi i operimit

Aktuatorët SAMSON Tipi 3271 dhe Tipi 3277 me sipërfaqe aktuatori 240, 350, dhe 700 cm² janë montuar në valvulat e serisë 240, 250, 280, dhe 290 (valvulat glob).

3.1 Tipi 3271

Aktuatori përbëhet kryesisht nga dy kasa diafragme (A1, A2), diafragma (A4) me pllakë diafragme (A5), dhe sustat (A10) (shiko Fig. 2).

Presioni i sinjalit p_{st} krijon forcën $F = p_{st} \cdot A$ në sipërfaqen e diafragmës A e cila kundërshtohet nga forcat (A10) në aktuator. Gama e punimit përcaktohet nga numri i sustave të përdorura dhe shtypja e tyre, duke



marrë parasysh lëvizjen nominale. Lëvizja është proporcionale me presionin e sinjalit p_{st} . Drejtimi i veprimit të boshtit të aktuatorit (A7) varet nga mënyra si janë instaluar sustat në aktuator.


Në aktuator mund të instalohen një maksimum prej 12 sustash (240 dhe 350 cm²) dhe një maksimum prej 18 sustash (700 cm²), të montuara pjesërisht brenda njëra tjetrës.

Kllapat bashkuese të boshtit (A26/27) lidhin boshtin e aktuatorit (A7) me boshtin e tapës të valvulës glob.

3.2 Tipi 3277

Parimi i operimit është njëloj si me atë të aktuatorit të tipit 3271. Aktuatori i tipit 3277 është i pajisur me një skelet shtesë në kasën e poshtme të diafragmës (A2) (shiko Fig. 3). Skeleti lejon lidhjen direkte të një pozicionuesi dhe/ose çelësi limiti. Dobia e këtij ndërtimi është që ndalesa e lëvizjes që ndodhet brenda skeletit është e mbrojtur nga ndikimet e jashtme.

Shikoni udhëzimet e montimit dhe operimit të aksesorëve të valvulës për t'u montuar për më shumë detaje mbi lidhjen e tyre dhe aksesorët e nevojshëm.



3.3 Drejtimi i veprimit

Drejtimi i veprimit përcaktohet nga mënyra si sustat (A10) dhe pllaka e diafragmës (A5) janë rregulluar në aktuator.

Me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit zgjatet", ajri i kompresuar aplikohet në lidhjen e presionit të sinjalit në kasën e poshtme të diafragmës.

Me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit tërhiqet", ajri i kompresuar aplikohet në lidhjen e presionit të sinjalit në kasën e sipërme të diafragmës.

Drejtimi i veprimit të aktuatorit mund të kthehet mbrapsht (shiko pjesën 6.3).

3.4 Rruga e presionit të sinjalit

3.4.1 Tipi 3271

Në versionin "boshti i aktuatorit zgjatet", presioni i sinjalit kalon përmes lidhjes së poshtme të presionit të sinjalit (S) në dhomën e poshtme të diafragmës dhe lëviz boshtin e aktuatorit (A7) lart duke kundërshtuar forcën e sustës (shiko Fig. 2, djathtas).

Në versionin "boshti i aktuatorit tërhiqet", presioni i sinjalit kalon përmes lidhjes së sipërme të sinjalit të presionit (S) në dhomën e sipërme të diafragmës dhe lëviz boshtin e aktuatorit (A7) poshtë duke kundërshtuar forcën e sustës (shiko Fig. 2, majtas).

3.4.2 Tipi 3277

Në versionin "boshti i aktuatorit zgjatet", një lidhje e presionit të sinjalit (S) ndodhet në anë të skeletit që ndodhet në dhomën e poshtme të diafragmës mbi një vrimë të brendshme (shiko Fig. 3, djathtas). Presioni i sinjalit lëviz boshtin e aktuatorit lart duke kundërshtuar forcën e sustës. Mund të lidhet një pozicionues duke përdorur një bllok lidhjeje në këtë pikë. Nuk nevojitet tubacion shtesë në aktuator. Shikoni dokumentacionin përkatës të pozicionuesit për më shumë detaje.

Në versionin "boshti i aktuatorit tërhiqet", presioni i sinjalit kalon përmes lidhjes së sipërme të sinjalit të presionit (S) në dhomën e sipërme të diafragmës dhe lëviz boshtin e aktuatorit (A7) poshtë duke kundërshtuar forcën e sustës (shiko Fig. 3, majtas).

3.5 Veprimi i sigurt

Kur sinjali i presionit reduktohet ose sinjali i kontrollit dështon, pozicioni i sigurt i valvulës së kontrollit varet nga fakti nëse sustat janë të instaluara në dhomën e sipërme ose të poshtme të diafragmës.

i Shënim

Veprimet e sigurt zbatohen për valvulat SAMSON seria 240, 250, 280 dhe 290 (valvulat glob).

3.5.1 Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit zgjatet" (FA)

Kur presioni i sinjalit reduktohet ose sinjali i kontrollit dështoin, sustat lëvizin boshtin e aktuatorit lart dhe mbyllin valvulën glob. Valvula hapet kur presioni i sinjalit rritet mjaftueshëm për të kapërcyer forcën e sustës.

3.5.2 Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit tërhiqet" (FE)

Kur sinjali i presionit reduktohet ose sinjali i kontrollit dështoin, sustat lëvizin boshtin e aktuatorit lart dhe hapin një valvul glob të montuar. Valvula mbyllet kur presioni i sinjalit rritet mjaftueshëm për të kapërcyer forcën e sustës.

3.6 Versionet

Aktuatorët pneumatikë të tipit 3271 dhe tipit 3277 me sipërfaqe aktuatori 240, 350 ose 700 cm² janë të disponueshme në versionet e mëposhtme:

- **Versioni standard**
Kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës janë bërë prej flete çeliku të lyer.
- **Version rezistent ndaj gërryerjes**
Kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës janë bërë prej flete inoksi (1.4301).
- **Volanti shtesë (montuar sipër)**
Aktuatorët mund të pajisen me një volant shtesë (të montuar sipër) (► T 8312).
- **Ndalesa e lëvizjes**
Aktuatorët si version special mund të pajisen me një ndalesë lëvizjeje të rregullueshme mekanikisht. Lëvizja reduktohet deri në 50% në të dyja drejtimet e veprimit (boshti zgjatet ose tërhiqet).
- **Volant i montuar anash**
Aktuatorët mund të kombinohen me një volant të tipit 3273 me montim anash me lëvizje maks. 30 mm (► T 8312).

3.7 Të dhëna teknike

Etiketa e të dhënave siguron informacione mbi versionin e aktuatorit (shiko pjesën 2.1).

i Shënim

Më shumë informacion gjenden në fletën e të dhënave ► T 8310-1.

Presioni i furnizimit

Presioni maksimal i lejuar i furnizimit është 6 bar në shërbimin e mbylljes. Shiko pjesën 6.2 për kufizime në shërbimin on/off.

Gama e temperaturës

Gama e temperaturës së lejuar varet nga shërbimi i aktuatorit dhe materiali i diafragmës:

Materiali i diafragmës	Gama e temperaturës
Shërbimi i mbylljes	
NBR	-35 deri në +90 °C -31 deri në +194 °F
EPDM	-50 deri në +120 °C -58 deri në +248 °F
Shërbimi on/off	
NBR	-20 deri në +90 °C -4 deri në +194 °F
EPDM	-40 deri në +120 °C -40 deri në +248 °F

Pajtueshmëria

Aktuatorët pneumatikë të tipit 3271 dhe 3277 mbajnë markën e konformitetit EAC




Përmasat dhe peshat

Përmasat dhe peshat janë renditur në tabelën 1. Gjatësitë dhe lartësitë në diafragmat e përmasave janë treguar në faqen 17 e më tej.


Tabela 1: Përmasat në mm dhe peshat në kg

Aktuatori		3271			3277		
Sipërfaqja e aktuatorit	cm ²	240	350	700	240	350	700
Lartësia	H	62	82	134	65	82	135
	H1	300	302	490	400	420	590
	H2 _{max}	345	365	540	445	465	640
	H4 _{rated} FA	75	75	90	75	75	90
	H4 _{max} FA	78	78	95	78	78	95
	H4 _{max} FE	78	85	104	78	85	104
	H5	–	–	–	101	101	101
	H6	34	34	34	34	34	34
	H7	–	–	65	–	–	65
Ndalimi i lëvizjes	H8	75	85	115	75	85	115
Gjerësia e skeletit	L	–	–	–	70	70	70
Diametri	ØD	240	280	390	240	280	390
	ØD1	180	250	315	180	250	315
	ØD2	10	16	16	16	16	16
Ød (fileta)		M30 x 1.5			M30 x 1.5		
Lidhja e ajrit	a	G ¼ ¼ NPT	G ¾ ¾ NPT	G ¾ ¾ NPT	G ¼ ¼ NPT	G ¾ ¾ NPT	G ¾ ¾ NPT
	a2	–	–	–	G ¾	G ¾	G ¾
Pesha	Pa volant	5	8	22	9	12	26
	Me volant	9	13	27	13	17	31


Vizatimet e përmasave




Versioni standard i tipit 3271 (700 cm²)




Versioni standard i tipit 3277 (240, 350 cm²)



Tipi 3277 (pamja anësore)



Tipi 3271 me ndalesë lëvizjeje



Tipi 3277 me volant

4 Masat për përgatitjen

Pas marrjes së ngarkesës, veproni si më poshtë:

1. Kontrolloni shtrirjen e dërgesës.
Krahasoni ngarkesën e marrë kundrejt shënimeve të dërgesës.
2. Kontrolloni ngarkesën për dëmtime transporti. Raportoijn SAMSON dhe agjentit të dërgesës çdo dëmtim (referoni shënimin e dërgesës).

4.1 Shpaketimi

Shënim

Mos e hiqni paketimin deri në momentin para se ta montoni.

Veproni si më poshtë për të ngritur dhe montuar aktuatorin:

1. Hiqni paketimin nga aktuatori.
2. Hidhni paketimet sipas rregullave përkatëse.

4.2 Transporti dhe ngritja

RREZIK

Rrezik për shkak të rrëzimit të ngarkesave të varura.

Qëndroni larg nga ngarkesat e varura ose që lëvizin.

PARALAJMËRIM

Rrezik i rrëzimit të pajisjeve ngritëse dhe rrezik dëmtimi nga aksesoret e ngritjes për shkak të tejkalimit të kapacitetit nominal të ngritjes.

– Përdorni vetëm pajisjet dhe aksesoret e aprovuar për ngirje kapaciteti minimal i ngritjes i të cilave është më i lartë se pesha e aktuatorit.

– Shikoni pjesën 3.7 për peshat.

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të rripave të lidhur jo mirë.

– Vrima e salduar e ngritjes në kasën e sipërme të diafragmës është bërë për të montuar dhe hequr aktuatorin si edhe ngritjen e aktuatorit pa valvul. Mos e ngrini të gjithë pjesën e valvulës së kontrollit duke përdorur vrimën e ngritjes.

– Mos i lidhni rripat mbajtës në ndalesën e lëvizjes.

– Mbani parasysht udhëzimet për ngritjen 4.2.2).

Këshillë

Departamenti i pas shitjes të SAMSON mund të sigurojë me kërkesë udhëzime më të detajuara për transportin dhe ngritjen.

4.2.1 Transporti

Aktuatori mund të transportohet duke përdorur pajisje ngritjeje (p.sh. vinç ose pirun).

→ Lëreni aktuatorin në konejnerin e transportit ose mbi paletë për ta transportuar.

→ Zbatoni udhëzimet e transportit.

Udhëzimet e transportit

- Mbrojeni aktuatorin nga ndikimet e jashtme (p.sh. goditjet).
- Mos e dëmtoni mbrojtësen nga gërryerja (bojë, lyerjet e sipërfaqes). Riparoni menjëherë çdo dëmtim.
- Mbrojeni aktuatorin nga lagështia dhe papastërtitë.
- Mbani parasysh temperaturat e lejuara (shiko pjesën 3.7).

4.2.2 Ngritja

Për të montuar një aktuator të madh, përdorni pajisje ngritjeje (p.sh. çengel ose pirun) për ta ngritur.

Udhëzimet e ngritjes

- Sigurojini rripat që të mos bien.
- Sigurohuni që rripat të hiqen nga aktuatori pasi të jetë montuar në valvul.
- Mos e lejon aktuatorin të anohet ose të rrëzohet.
- Mos i lini ngarkesat të varura kur ndërprisni punën për kohë të gjatë.
- Sigurohuni që rripi shtesë midis vrimës së ngritjes dhe pajisjes mbajtëse (çengel, çikrik, etj.) nuk mban ngarkesë kur ngrini valvula kontrolli më të mëdha se DN 150 me aktuatorin të montuar tashmë. Rripi mbron vetëm valvulën e kontrollit nga animi ndërsa montohet. Para se ta ngrini valvulën e kontrollit, shtrëngoni rripin. Rripat e lidhur në trupin e valvulës duhet ta mbajnë të gjithë ngarkesën (shiko Fig. 5).

Ngritja e aktuatorit (pa valvul)

! NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të rripave të lidhur jo mirë.

Vrima e salduar e ngritjes në kasën e sipërme të diafragmës është bërë për të montuar dhe hequr aktuatorin si edhe ngritjen e aktuatorit pa valvul. Mos e ngrini të gjithë pjesën e valvulës së kontrollit duke përdorur vrimën e ngritjes.

1. Lidhni një rrip në vrimën ngritëse të aktuatorit dhe në pajisjen ngritëse (p.sh. çengeli) të vinçit ose pirunit (shiko Fig. 4).

2. Ngrijeni me kujdes aktuatorin. Kontrolloni nëse pajisja ngritëse dhe aksesoret mund ta mbajnë peshën.
3. Lëvizeni aktuatorin me qetësi në vendin e montimit.
4. Montoni aktuatorin në valvul. Shiko pjesën 5.1.
5. Hiqni rripat pas montimit.

💡 Këshillë

- Rekomandojmë të përdorni një çengel me shul sigurie (shiko Fig. 4). Shuli i sigurisë nuk lejon që rripat të rrëshqasin ngjatë ngritjes dhe transportit.
- Ekzistojnë mjete të veçanta për ngritjen e aktuatorëve me sipërfaqe aktuatori 240 dhe 350 cm² (► AB 0100).




Fig. 4: Pikat e ngritjes në aktuator




Fig. 5: Pikat e ngritjes në valvulën e kontrollit (shembull)

Ngrijeni të gjithë pjesën e valvulës së kontrollit

- Shikoni dokumentacionin e shoqëruar të valvulës për udhëzime se si ta ngrini një valvul kontrollit.

4.3 Ruajtja

! NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të ruajtjes jo të mirë.

- Zbatoni udhëzimet për ruajtjen.
- Shmangni ruajtjen për kohë të gjatë.
- Kontakti SAMSON në rast të kushteve të ndryshme të ruajtjes ose ruajtjes për kohë të gjatë.

i Shënim

Rekomandojmë që të kontrolloni rregullisht aktuatorin dhe kushtet e ruajtjes gjatë ruajtjes për kohë të gjatë.

Udhëzime për ruajtjen

- Kur valvula dhe aktuatori janë të montuar tashmë, mbani parasysh kushtet e ruajtjes për valvulat e kontrollit. Shikoni dokumentacionin e shoqëruar të valvulës.
- Mbrojeni aktuatorin nga ndikimet e jashtme (p.sh. goditjet).
- Mos e dëmtoni mbrojtësen nga gërryerja (bojë, lyerjet e sipërfaqes). Riparoni menjëherë çdo dëmtim.
- Mbrojeni aktuatorin nga lagështia dhe papastërtitë. Ruajeni në lagështi relative prej më pak se 75%. Në hapësira të lagështa, mos lejoni kondensimin. Nëse

është e nevojshme, përdorni një agjent tharjeje ose ngrohje.

- Sigurohuni që temperatura e ambientit të jetë pa acide ose materiale të tjera gërryese.
- Mbani parasysh temperaturat e lejuara (shiko pjesën 3.7).
- Mos lini asnjë objekt mbi aktuator.

Udhëzime të veçanta për elastomeret

Elastomer, p.sh. diafragma e aktuatorit

- Për t'i mbajtur elastomeret në formë dhe për të mos lejuar plasaritjen, mos i përthyeri ose mos i varni.
- Rekomandojmë që elastomeret të ruhen në temperaturë 15 °C.
- Mbajini elastomeret larg nga lubrifikantët, lëndët kimike, solucionet dhe karburantet.

💡 Këshillë

Departamenti i pas shitjes i SAMSON mund t'ju japë udhëzime ruajtjeje me të detajuara me kërkesë.

4.4 Përgatitja për instalimin

Veproni si më poshtë

- ➔ Kontrolloni aktuatorin për dëmtime.
- ➔ Kontrolloni për t'u siguruar që ndërtimi i tipit, materiali dhe gama e temperaturës së aktuatorit të përputhen me kushtet e ambientit (temperatura, etj.).
- ➔ Kontrolloni matësin e presionit të instaluar në aksesoret e valvulës për t'u siguruar që të funksionojë.
- ➔ Kur valvula dhe aktuatori janë të montuar tashmë, kontrolloni forcat e shtrëngimit të bashkimeve me bulona (► AB 0100). Komponentët mund të lirohen gjatë transportit.

5 Montimi dhe vënia në punë

Valvulat e kontrollit SAMSON jepen të gatshme për përdorim. Në raste të veçanta, valvula dhe aktuatori jepen veçmas dhe duhet të montohen në vend. Procedura për montimin dhe vënien në punë të aktuatorit janë treguar më poshtë.

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të forcave të shtrëngimit tepër të larta ose tepër të ulëta.

Mbani parasysh forcat e specifikuara gjatë shtrëngimit të komponentëve të aktuatorit. Forcat e shtrëngimit tepër të larta bëjnë që pjesët të konsumohen më shpejt. Pjesët që nuk janë shtrënguar mirë mund të lirohen. Mbani parasysh forcat e specifikuara për shtrëngimin (► AB 0100).

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të përdorimit të pjesëve të papërshtatshme. Përdorni vetëm mjetet e aprovuara nga SAMSON (► AB 0100).

Shënim

Shikoni dokumentacionin e shoqëruar të valvulës për udhëzime të mëtejshme montimi.

5.1 Montimi i aktuatorit në valvul

Veproni si më poshtë nëse valvula dhe aktuatori nuk janë montuar nga SAMSON.


Shënim

- Hiqeni aktuatorin e montuar para se të montoni një aktuator tjetër (shiko pjesën 9.2).
- Shtypja përpara e sustave të aktuatorit rrit shtytjen dhe pakëson lëvizjen e aktuatorit (shiko pjesën 5.2).

Këshillë

Valvula dhe aktuatori janë montuar duke i kushtuar vëmendje të veçantë gamës së punimit të aktuatorit dhe drejtimit të veprimit. Këto detaje janë specifikuar në etiketën e të dhënave të aktuatorit (shiko pjesën 2.1).

1. Lironi dadon e bllokimit (10) dhe dadon e konektorit të boshtit (9) në valvul.
2. Shtypni tapën së bashku me boshtin e tapës fort në unazën e folesë.
3. Vidhosni dadon e bllokimit dhe dadon bashkuese të boshtit.
4. Hiqni kllapat në konektorin e boshtit (A26/27) dhe dadon unazë (A8) nga aktuatori.
5. Futni dadon unazë mbi boshtin e tapës.
6. Vendoseni aktuatorin në kapakun e valvulës (2) dhe sigurojeni me dadon unazë.
7. Përcaktoni vlerat e gamës së presionit të sinjalit të poshtëm dhe të sipërm:



2	Kapaku/flanxha	A8	Dado unaze
8	Unaza me fileta	A26/27	Kllapat e konektorit të boshtit
9	Dado e konektorit të boshtit	Përmasa a	Shiko tabelën 2
10	Dado bllokimi	Përmasa x	Shiko tabelën 3
84	Shkalla treguese e lëvizjes		
A7	Boshti i aktuatorit		

Fig. 6: Aktuatori pneumatik i tipit 3271 i montuar mbi valvul glob

Vlera e poshtme e gamës së presionit të sinjalit është e njëjtë me vlerën minimale të gamës së punimit ose gamës së operimit (me susta të shtypura).

Vlera e sipërme e gamës së presionit të sinjalit është e njëjtë me vlerën maksimale të gamës së punimit ose gamës së operimit (me susta të shtypura).

Për sustat e aktuatorëve që duhet të shtypen më pas, përcaktoni gamën e presionit të sinjalit të sipërme dhe të poshtme siç tregohet në pjesën 5.2.

8. Përcaktimi i drejtimit të veprimit

Boshti i aktuatorit zgjatet

Aplikoni një presion sinjali që përket me vlerën e poshtme të gamës së presionit të sinjalit në lidhjen e dhomës së poshtme të diafragmës.

Boshti i aktuatorit tërhiqet

Aplikoni një presion sinjali që përket me vlerën e sipërme të gamës së presionit të sinjalit në lidhjen e dhomës së sipërme të diafragmës.

9. Vidhosni dadon bashkuese të boshtit (9) me dorë derisa të prekë boshtin e aktuatorit (A7).
10. Rrotulloni dadon bashkuese të konektorit një çerek rrotullimi më shumë dhe sigurojeni këtë pozicion me dadon e bllokimit (10).
11. Poziciononi kllapat e konektorit të boshtit (A26/27) dhe vidhosini mirë.
12. Sigurohuni që përmasa a të jetë rregulluar siç tregohet në tabelën 2.
13. Poziciononi treguesin e lëvizjes (84) me majën e kllapës së konektorit të boshtit.

Tabela 2: Vlerat për përmasat x ¹⁾ (shiko Fig. 6)

Sipërfaqja e aktuatorit	Lëvizja në mm	Përmasa a në mm
240	0 (0 %)	75
	15 (100 %)	60
	17 (112,5 %)	58
350	0 (0 %)	75
	15 (100 %)	60
	19 (125 %)	53
700	0 (0 %)	90
	30 (100 %)	60
	38 (125 %)	52

¹⁾ Tipi 3271: ana e poshtme e kasës së poshtme deri në pjesën e sipërme të boshtit të aktuatorit
 Tipi 3277: ana e poshtme e kasës së poshtme deri në pjesën e sipërme të boshtit të aktuatorit

5.2 Shtypja e sustave

Duke shtypur paraparakisht sustat në aktuator, mund të arrihen të mëposhtmet:

- Rritet shtytja (vetëm aktuatorët me "boshti zgjatet")
- Në kombinim me një valvul SAMSON: diapazoni i lëvizjes së aktuatorit mund të përshtatet me një diapazon lëvizje më të vogël të valvulës

i Shënim

Aktuatorët që janë tensionuar tashmë nga SAMSON pa montuar valvulën janë emërtuar përkatësisht.

Përveç kësaj, ata mund të dallohen nga tre bulonat e gjatë me dado që dalin nga fundi i kasës së diafragmës. Ata lejojnë që shtypja e sustës të lirohet njëllor kur çmontohet aktuatori (shiko pjesën 9.3).

5.2.1 Shtrëngimi i sustave

1 NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të sustave për shkak të sustave që nuk shtrëngohen njëllor.

- Shprëndani bulonat dhe dadot kapëse njëllor në të gjithë perimetrimin.
- Shtrëngoni dadot gradualisht në lëvizje tërthore.

1. Shprëndani bulonat e gjatë (A22) njëllor përreth perimetrimin.
2. Vidhosni dadot e gjata (A23) së bashku me një rondele (A25) në bulonat kapës

(A22) derisa të qëndrojnë në kasën e poshtme të diafragmës (A2).


3. Për të shtrënguar sustat njëllor, shtrëngoni dadot (A23) gradualisht në lëvizje tërthore derisa të dyja kasat e diafragmës (A1, A2) të qëndrojnë mbi diafragmë (A4). Mbani kokën e bulonit të palëvizur me një mjet të përshtatshëm dhe aplikoni forcën e shtrëngimit në dado. Mbani parasysht forcat e shtrëngimit.
4. Futni bulonat e shkurtër (A20) në vrimat e synuara në kasat e diafragmës (A1, A2).
5. Vidhosni dadot e shkurtra (A21) me rondele (A25) në bulona (A20). Mbani parasysht forcat e shtrëngimit.

5.2.2 Rritja e shtytjes së aktuatorit

Shtytja mund të rritet në aktuatorë me drejtimin e veprimit "boshti zgjatet". Për të arritur këtë, sustat e aktuatorëve mund të shtypen deri në 12,5% (240 cm²) ose deri në 25% (350 dhe 700 cm²) e lëvizjes ose punimit të tyre.

Shembull: Është e nevojshme shtypja paraprake për një gamë punimi prej 0,4 deri në 2 ar. 25% e këtij diapazoni përket me 0,4 bar. Prandaj, gama e presionit të sinjalit lëviz me 0,4 bar deri në 0,8 bar në 2,4 bar. Vlera e re e poshtme e presionit të sinjalit është 0,8 bar dhe vlera e re e sipërme e presionit të sinjalit është 2,4 bar.

➔ Shkruani gamën e re të presionit të sinjalit prej 0,8 deri në 2,4 bar në etiketën e të dhënave të aktuatorit si gamë punimi me susta të shtypura.



- | | | | |
|-----|-----------------------------|-----|------------------------------------|
| A1 | Kasa e sipërme e diafragmës | A22 | Bulon hekzagon (shtypje paraprake) |
| A2 | Kasa e poshtme e diafragmës | A23 | Dado hekzagon (shtypje paraprake) |
| A4 | Diafragma | A24 | Tapa e boshatisjes |
| A20 | Vidë hekzagon | A25 | Rondele |
| A21 | Dado hekzagon | | |

Fig. 7: Aktuatori me dado dhe bulona kapjeje

5.2.3 Përshtatja e diapazonit të lëvizjes

Në disa raste, valvula dhe aktuatori kanë lëvizje nominale të ndryshme. Në varësi të drejtimit të veprimit, veproni si më poshtë:

Drejtimi i veprimit: boshti i aktuatorit zgjatet

Gjithmonë përdorni aktuatorë me susta të shtypura kur lëvizja nominale e valvulës është më e vogël se lëvizja nominale e aktuatorit.

Shembull: Valvul DN 50 me lëvizje nominale 15 mm dhe aktuator 700 cm² me lëvizje nominale 30 mm; 0,4 deri në 2 bar gamë punimi.

Presioni i sinjalit për gjysmën e lëvizjes së aktuatorit (15 mm) është 1,2 bar. Duke ia shtuar vlerës së poshtme të gamës së presionit të sinjalit prej 0,4 bar rezultojnë në një presion sinjali prej 1,6 bar të nevojshëm për shtypjen paraprake të sustave. Vlera e re e poshtme e sinjalit është 1,6 bar dhe vlera e re e sipërme e sinjalit është 2,4 bar.

- Shkruani gamën e re të presionit të sinjalit prej 1,6 deri në 2,4 bar në etiketën e të dhënave të aktuatorit si gamë operimi me susta të shtypura paraprakisht.

Drejtimi i veprimit: boshti i aktuatorit tërhiqet

Sustat e aktuatorëve me veprimin "boshti tërhiqet" nuk mund të shtypen paraprakisht. Kur një valvul SAMSON kombinohet me një aktuator të madh (p.sh. lëvizja nominale e aktuatorit është më e madhe se lëvizja nominale e valvulës), vetëm gjysma e parë e gamës së punimit të aktuatorit mund të përdoret.

Shembull: Valvul DN 50 me lëvizje nominale 15 mm dhe aktuator 700 cm² me lëvizje nominale 30 mm; 0,2 deri në 1 bar gama e punimit.

Në gjysmë të lëvizjes së valvulës, gama e operimit është midis 0,2 dhe 0,6 bar.

6 Operimi

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik shtypjeje që lind nga pjesët lëvizëse
Aktuatori përmban pjesë lëvizëse (boshti i aktuatorit) i cili mund të lëndojë duart ose gishtat nëse futen në aktuator.

- Mos futni duart ose gishtat në skelet kur valvula është në punë.
- Kur punoni në aktuator, shkëputni dhe mbyllni furnizimin e ajrit pneumatik si edhe sinjalin e kontrollit.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal kur aktuatori shfryhet

Vishni mbrojtëse për sytë kur punoni shumë afër valvulës së kontrollit.

❗ NJOFTIM

Operimi i penguar nga një bosht aktuatori i bllokuar.

Mos pengoni lëvizjen e boshtit të aktuatorit duke futur objekte në rrugën e tij.

6.1 Shërbimi i mbylljes

Aktuatorët pneumatikë të tipit 3271 dhe tipit 3277 me sipërfaqe aktuatori 240, 350 dhe 700 cm² janë ndërtuar për një presion furnizimi maksimal prej 6 bar kur përdoren për shërbim mbylljeje.

6.2 Shërbimi on/off

Në shërbimin on/off, presioni i furnizimit duhet të kufizohet në varësi të gamës së punimit ose gamës së operimit të aktuatorit. Gama e punimit ose gama e operimit që zbatohet në të cilën aktuatori mund të lëvizë është shkruar në etiketën e të dhënave (shiko pjesën

Boshti i aktuatorit tërhiqet (FE)

Për drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit tërhiqet (FE)", presioni i lejuar i furnizimit nuk duhet të kalojë vlerën e sipërme të gamës së punimit me më shumë se 3 bar:

Gama e punimit	Veprimi i sigurt	Presioni maks. i furnizimit
0,2 deri në 1,0 bar	Boshti i aktuatorit tërhiqet	4 bar
0,4 deri në 2,0 bar		5 bar
0,6 deri në 3,0 bar		6 bar

Boshti i aktuatorit zgjatet (FA)

Me veprimin e sigurt "boshti i aktuatorit tërhiqet" dhe ndalesën e lëvizjes, presioni i furnizimit nuk duhet të kalojë vlerën e sipërme të diapazonit të sustës me më shumë se 1,5 bar.


Pika të tjera që zbatohen në lidhje me operimin:

- Emërtoni aktuatorin me presionin e furnizimit të reduktuar me një ngjitëse ("Presioni maks. i furnizimit i limituar në ... bar").
- Aplikoni vetëm presionin e sinjalit në lidhjen e presionit të sinjalit (S) në dhomën e diafragmës së aktuatorit e cila nuk përmban asnjë sustë (shiko Fig. 3).

→ Përdorni vetëm tapa shfryrjeje që lejojnë ajrin të kalojë në to (A16 në Fig. 3).

6.3 Kthimi i drejtimit të veprimit

Drejtimi i veprimit dhe (veprimi i sigurt) i aktuatorëve pneumatikë mund të ndryshohet. Veprimi i sigurt është treguar në etiketën e të dhënave nga një simbol:



⚠ RREZIK

Rrezik i plasjes së aktuatorëve. Aktuatorët janë në presion. Hapja e papërshtatshme mund të bëjë që komponentët e aktuatorit të plasin. Para se të filloni punë në aktuator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të aktuatorit.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të sustave në tension. Aktuatorët me susta të shtypura paraprakisht janë nën tension. Ato mund të dallohen nga tre bulona të gjatë që dalin nga fundi i aktuatorit. Para se të filloni punë në aktuator, lironi kompresionin nga sustat e shtypura paraprakisht (shiko pjesën 9.3).

! NJOFTIM

Rrezik defekti për shkak të detajeve të gabuara në etiketën e të dhënave pas kthimit mbrapsht të drejtimit të veprimit.

Pas kthimit, simboli dhe ID e konfigurimit në etiketën e të dhënave nuk janë më të vlefshme. Kontaktoni SAMSON për të kërkuar një etiketë të dhënash të re.

6.3.1 Kthimi i drejtimit të veprimit nga boshti zgjatet në boshti tërhiqet


1. Ngriji aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
2. Zhvidhosni dadot (A21) dhe bulonat (A20) në kasën e diafragmës.
3. Lironi shtypjen e sustës së aktuatorëve me susta të shtypura paraprakisht (shiko pjesën 9.3).
4. Ngriji kasën e sipërme të diafragmës (A1) dhe hiqni sustat (A10).
5. Tërhiqni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) nga kasa e poshtme e diafragmës (A2).
6. Kapni pjesën e poshtme të boshtit të aktuatorit (A7) në një morsë uke përdorur nofulla mbrojtëse. Sigurohuni që boshti i aktuatorit të mos dëmtohet.
7. Zhvidhosni dhe hiqni dadon manikotë (A15) ndërsa mbani dadon (A9) pa lëvizur.

! NJOFTIM

Defekt për shkak të lirimit të dados.
Dadoja (A9) në boshtin e aktuatorit shërben për të rregulluar përmasën x. Mos e zhvidhosni dadon. Nëse dadoja është liruar, rregulloni përmasën x siç tregohet në tabelën 3.

8. Hiqni pllakën e diafragmës (A5) me diafragmën (A4) nga boshti i aktuatorit dhe vendosini përsëri në radhë të kundërt.
9. Shtrengoni dadon manikotë (A15) ndërsa mbani dadon (A9) pa lëvizur. Mbani parasysh forcat e shtrengimit.
10. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në boshtin e aktuatorit (A7).
11. Kapni kasën e sipërme të diafragmës (A1) me pjesën e hapur të drejtuar lart në një fiksion të përshtatshëm.

12. Vendoseni pjesën e pllakës së diafragmës së bashku me boshtin e aktuatorit (A7) të drejtuar lart në kasën e diafragmës (A1).
13. Vendosni sustat (A10) në pllakën e diafragmës (A5) duke i qendëruar në pjesët e futura përkatëse.
14. Drejtoni me kujdes kasën e poshtme të diafragmës (A2) mbi boshtin e aktuatorit (A7) dhe vendoseni mbi susta (A10). Sigurohuni që elementët e izolimit të mos dëmtohen. Sigurohuni që lidhjet e ajrit të kompresuar në kasa (A1, A2) të pozicionohen saktë me njëra tjetrën.
15. Shtrengoni kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës (A1, A2) së bashku duke përdorur dadot (A21) dhe bulonat (A20). Mbani parasysh forcat e shtrengimit.



16. Zhvidhosni tapën e shfryrjes (A16) nga lidhja e sipërme e presionit të sinjalit dhe vidhoseni në lidhjen e poshtme (S). Sustat e aktuatorit, të cilat tani shtyjnë kundrejt pllakës së diafragmës nga poshtë, bëjnë që boshti i aktuatorit të tërhiqet. Presioni i sinjalit është lidhur me lidhjen e sipërme (S) në kasën e sipërme të diafragmës. Si rezultat, boshti i aktuatorit zgjatet duke i kundërshtuar forcës së sustës ndërsa presioni i sinjalit rritet.
17. Ngjitni një etiketë të dhënash të re me simolin e ndryshuar dhe ID-në e re të konfigurimit në aktuator.

6.3.2 Kthimi i drejtimit të veprimit nga boshti tërhiqet në boshti zgjatet

1. Ngrijeni aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
2. Zhvidhosni dadot (A21) dhe bulonat (A20) në kasën e diafragmës.
3. Ngrijeni kasën e sipërme të diafragmës (A1).

4. Tërhiqeni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) nga aktuatori.
5. Nxirrini sustat (A10) nga kasa e poshtme e diafragmës (A2).
6. Zhvidhosni dhe hiqni dadon manikotë (A15) ndërsa mbani dadon (A9) pa lëvizur.

! NJOFTIM


Defekt për shkak të liritimit të dados. Dadoja (A9) në boshtin e aktuatorit shërben për të rregulluar përmasën x. Mos e zhvidhosni dadon. Nëse dadoja është zhvidhosur, rregulloni përsëri përmasën x siç tregohet në tabelën 3.

7. Kapni pjesën e poshtme të boshtit të aktuatorit (A7) në një morsë uke përdorur nifulla mbrojtëse. Sigurohuni që boshti i aktuatorit të mos dëmtohet.
8. Hiqni pllakën e diafragmës (A5) me diafragmën (A4) nga boshti i aktuatorit dhe vendosini përsëri në radhë të kundërt.

Tabela 3: Vlerat për përmasën x (shiko Fig. 8)

Tipi	Sipërfaqja e aktuatorit	Lëvizja në mm	Përmasa x në mm (sipër dados der në fund të boshtit të aktuatorit)
3271	240	15	98,25
	350	15	107,25
	700	30	144
3277	240	15	–
	350	15	209
	700	30	246

9. Shtrëngoni dadon manikotë (A15) ndërsa mbani dadon (A9) pa lëvizur. Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.
10. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në boshtin e aktuatorit (A7).
11. Vendosni pjesën e pllakës së diafragmës së bashku me boshtin e aktuatorit (A7) të drejtuar poshtë në kasën e poshtme të diafragmës (A2). Sigurohuni që elementët e izolimit të mos dëmtohen.
12. Vendosni sustat (A10) në kasën e poshtme të diafragmës duke i qendëruar në vendet e futura të posaçme.
13. Vendoseni sipër kasës së sipërme të diafragmës (A1).
14. Nëse është e nevojshme, shtypni paraprakisht sustat (shiko pjesën 5.2).
15. Shtrëngoni kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës (A1, A2) së bashku duke përdorur dadot (A21) dhe bulonat (A20). Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.
16. Zhvidhosni tapën e shfryrjes (A16) nga lidhja e poshtme e presionit të sinjalit dhe vidhoseni në lidhjen e sipërme (S). Sustat e aktuatorit, të cilat tani shtyjnë kundrejt pllakës së diafragmës nga sipër bëjnë që boshti i aktuatorit të zgjatet. Presioni i sinjalit është i lidhur në lidhjen e poshtme (S) në kasën e poshtme të diafragmës. Si rezultat, boshti i aktuatorit tërhiqet duke i kundërshtuar forcës së sustës ndërsa presioni i sinjalit rritet.
17. Ngjitni një etiketë të dhënash të re me simolin e ndryshuar dhe ID-në e re të konfigurimit në aktuator.



- A7 Boshti i aktuatorit
- A50 Sipër boshtit të aktuatorit
- A51 Konektori i boshtit
- A55 Tregues
- A60 Volant
- A66 Dado bllokimi
- A75 Kasa e sipërme e diafragmës

Fig. 9: Aktuator pneumatik me volant

6.4 Versioni me volant

Konektori i boshtit (A51) lidhet me boshtin e aktuatorit (A7) me boshtin e aktuatorit A50 të volantit. Pozicioni i boshtit të aktuatorit mund të rregullohet duke përdorur volantën (A60). Shiko Fig. 9.

i Shënim

Nëse doni të montoni një volant në aktuator, kontaktoni departamentin e pas shitjes të SAMSON.

6.4.1 Zgjatja manualisht e boshtit të aktuatorit

1. Lironi dadon bllokuese (A66) për të zhbllokuar volantën (A60).
2. Rrotulloni volantën në drejtim të akrepave të orës për të zgjatur boshtin e aktuatorit.
3. Për të kaluar nga operimi manual në operim automatik, vendoseni volantën në pozicion neutral duke pozicionuar treguesin (A55) me zgavrën në konektorin e boshtit (A51).
4. Shtërngoni dadon bllokuese (A66) për të bllokuar volantën.

6.4.2 Tërheqja manualisht e boshtit të aktuatorit

1. Lironi dadon bllokuese (A66) për të zhbllokuar volantën (A60).

2. Rrotulloni volantën në drejtim të kundërt të akrepave të orës për të tërhequr boshtin e aktuatorit
3. Për të kaluar nga operimi manual në operim automatik, vendoseni volantën në pozicion neutral duke pozicionuar treguesin (A55) me zgavrën në konektorin e boshtit (A51).
4. Shtërëngoni dadon bllokuese (A66) për të bllokuar volantën.

6.5 Rregullimi i ndalesës së lëvizjes

Në versionin me ndalesë lëvizjeje, lëvizja maksimale dhe minimale e aktuatorit mund të kufizohet si më poshtë:

Drejtimi i veprimt	Ndalesa min.	Ndalesa maks.
Boshti zgjatet (FA)	0 deri në 125 %	50 deri në 125 %
Boshti tërhiqet (FE)	0 deri në 100 %	50 deri në 100 %

6.5.2 Ndalesa e sipërme e lëvizjes (lëvizja maksimale)

1. Lironi dadon e bllokimit të sipërme (A74).
2. Rregulloni kapakun (A73) në ndalesën e nevojshme të lëvizjes.
3. Shtërëngoni përsëri dadon e sipërme të bllokimit (A74).

6.5.1 Ndalesa e poshtme e lëvizjes (lëvizja minimale)

1. Lironi dadon e bllokimit të sipërme (A74) dhe zhvidhosni kapakun (A73).
2. Lironi dadon bllokuese të poshtme (A74) dhe rrotulloni dadon e rregullimit (A70) për të rregulluar ndalesën e lëvizjes.
3. Shtërëngoni dadon bllokuese të poshtme (A74).
4. Vendosni kapakun (A73) dhe shtërëngoni përsëri dadon bllokuese (A74).




Fig. 10: Ndalesa e lëvizjes

7 Shërbimi

RREZIK

Rrezik i plasjes së aktuatorëve.
Aktuatorët janë në presion. Hapja e papërshtatshme mund të bëjë që komponentët e aktuatorit të plasin.
Para se të filloni punë në aktuator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të aktuatorit.

PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të sustave në tension.
Aktuatorët me susta të shtypura paraprakisht janë nën tension. Ato mund të dallohen nga tre bulona të gjatë që dalin nga fundi i aktuatorit.
Para se të filloni ndonjë punë në aktuator, lironi kompresionin nga sustat e shtypura paraprakisht (shiko pjesën 9.3).

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të shërbimeve ose riparimeve të gabuara.

- Mos bëni vetë asnjë punë shërbimi ose riparimi përveç aktivitetëve të përshkruara në këtë pjesë. Kontaktoni departamentin e pas shitjes të SAMSON.
- Puna e shërbimeve dhe riparimeve duhet të bëhet vetëm nga stafi i trajnuar për këtë qëllim.

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të forcave të shtrëngimit tepër të larta ose tepër të ulëta.

Mbani parasysh forcat e specifikuara gjatë shtrëngimit të komponentëve të aktuatorit. Forcat e shtrëngimit tepër të larta bëjnë që pjesët të konsumohen më shpejt. Pjesët që nuk janë shtrënguar mirë mund të lirohen. Mbani parasysh forcat e specifikuara për shtrëngimin (► AB 0100).

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të përdorimit të pjesëve të papërshtatshme. Përdorni vetëm mjetet e aprovuara nga SAMSON (► AB 0100).

NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të aktuatorit për shkak të përdorimit të lubrifikantëve të papërshtatshëm. Përdorni vetëm lubrifikantët e aprovuar nga SAMSON (► AB 0100).

Shënimi

- Garancia e produktit bëhet e pavlefshme nëse puna e shërbimit ose riparimit që nuk është përshkruar në këto udhëzime bëhet pa aprovimin e mëparshëm nga departamenti i pas shitjes i SAMSON.
- Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale nga SAMSON të cilat i përmbahen specifikimeve origjinale.

7.1 Ndërrimi i diafragmës

! NJOFTIM

Rrezik defektesh për shkak të kapëses së dëmtuar të tubit.

Mos i përdorni përsëri kapëset e tubave. Përdorni një kapëse tubi të re çdo herë që ndërrohet diafragma.

! NJOFTIM

Rrezik i dëmtimit të pronës dhe defektesh për shkak të montimit të gabuar të kapëses së tubit.


Shtrengoni kapësen e tubit me çelës dhe përdorni një mjet të veçantë për ta pozicionuar në qendër.

Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit zgjatet" (FA)

1. Ngrijeni aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
2. Zhvendhosni dadot (A21) dhe bulonat (A20) në kasën e diafragmës.

3. Lironi kompresionin e sustës së aktuatorit me sustat e shtypura paraprakisht (shiko pjesën 9.3).
4. Ngrijeni kasën e sipërme të diafragmës (A1) dhe hiqni sustat (A10).
5. Tërhiqni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) nga kasa e poshtme e diafragmës (A2).
6. Kapni pjesën e poshtme të boshtit të aktuatorit (A7) në një morsë uke përdorur nofulla mbrojtëse. Sigurohuni që boshti i aktuatorit të mos dëmtohet.
7. **240 cm²:** lironi shulin e kapëses së tubit (A6). Nxirreni kapësen e tubit (A6) dhe diafragmën (A4) nga pllaka e diafragmës (A5).

350 dhe 700 cm²: lironi shulin e kapëses së tubit (A6). Nxirreni kompresorin (A19), kapësen e tubit (A6), dhe diafragmën (A4) nga pllaka e diafragmës (A5).



- | | |
|-----|------------------------------------|
| A4 | Diafragma |
| A5 | Pllaka e diafragmës |
| A6 | Kapëse tubi |
| A7 | Boshti i aktuatorit |
| A9 | Dado heksagon |
| A15 | Dado manikotë |
| A19 | Kompresori në kllapën e tubit (A6) |

Fig. 11: Rregullimi i pjesëve për drejtimin e veprimit "boshti i zgjatet"

8. Montoni diafragmën e re (A4). Sigurohuni që diafragma e re të jetë pozicionuar mirë me pllakën e diafragmës. Vija imagjinare pëmres dy pjesëve të futura përballë njëra tjetrës për sustat në pllakën e diafragmës duhet të pozicionohet në qendër midis dy vrimave të bulonave në diafragmë (shiko Fig. 12).
 9. Vendosni kapësen e tubit (A6) rrafsh në zgavër në diafragmë (A4) të posaçme për të.
 10. **240 cm²**: rrotulloni vidën në shulën e kapëses së tubit derisa kapësja e tubit të qëndrojë komplet në zgavër. Shtrëngoni vidën e shulit duke përdorur një mjet të përshtatshëm. Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.
- 350 dhe 700 cm²**: vidhosni vidën në shulën e kapëses së tubit derisa të mbetet

një hapësirë prej vetëm pak milimetrash midis diafragmës (A4) dhe kapëses së tubit (A6).

Vendosni dhe poziciononi kompresorin (A19) poshtë shulit të kapëses (shiko Fig. 12).

Shtrëngoni vidën e shulit duke përdorur një mjet të përshtatshëm. Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.

11. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në boshtin e aktuatorit (A7).
12. Vendosni pjesën e diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma e re (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) në kasën e poshtme të diafragmës (A2). Sigurohuni që elementët e izolimit të mos dëmtohen.





Fig. 12: Pozicionimi i diafragmës

13. Vendosni sustat (A10) në kasën e poshtme të diafragmës duke i qendëruar në vendet e futura të posaçme.
14. Vendoseni sipër kasës së sipërme të diafragmës (A1).
15. Nëse është e nevojshme, shtypni paraprakisht sustat (shiko pjesën 5.2).
16. Shtrëngoni kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës (A1, A2) së bashku duke përdorur dadot (A21) dhe bulonat (A20). Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.
17. Montoni aktuatorin në valvul (shiko pjesën 5.1).
4. Tërhiqeni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) nga aktuatori.
5. Nxirrini sustat (A10) nga kasa e poshtme e diafragmës (A2).
6. Kapni pjesën e poshtme të boshtit të aktuatorit (A7) në një morsë uke përdorur nofulla mbrojtëse. Sigurohuni që boshti i aktuatorit të mos dëmtohet.
7. **240 cm²:** lironi shulin e kapëses së tubit (A6). Nxirreni kapësen e tubit (A6) dhe diafragmën (A4) nga pllaka e diafragmës (A5).

Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit tërhiqet" (FE)

1. Ngriji aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
2. Zhvidthosni dadot (A21) dhe bulonat (A20) në kasën e diafragmës.
3. Ngriji kasën e sipërme të diafragmës (A1).
8. Montoni diafragmën e re (A4). Sigurohuni që diafragma të pozicionohet mirë me pllakën e diafragmës. Vija imagjinare midis dy pjesëve të futura përballë njëra tjetrës për sustat në pllakën e diafragmës duhet të pozicionohet në

350 dhe 700 cm²: lironi shulin e kapëses së tubit (A6). Nxirri kompresorin (A19), kapësen e tubit (A6), dhe diafragmën (A4) nga pllaka e diafragmës (A5).



- A4 Diafragma
- A5 Pllaka e diafragmës
- A6 Kapëse tubi
- A7 Boshti i aktuatorit
- A9 Dado hekzagon
- A15 Dado manikotë
- A19 Kompresori në kllapën e tubit (A6)

Fig. 13: Rregullimi i pjesëve për drejtimin e veprimit "boshti tërhiqet"

qendër midis dy vrimave të bulonave në diafragmë (shiko Fig. 12).

9. Vendosni kapësen e tubit (A6) rrafsh në zgavër në diafragmë (A4) të posaçme për të.
10. **240 cm²**: rrotulloni vidën në shulin e kapëses së tubit derisa kapësja e tubit të qëndrojë komplet në zgavër. Shtërëngoni vidën e shulit duke përdorur një mjet të përshtatshëm. Mbani parasysh forcat e shtërëngimit.

350 dhe 700 cm²: vidhosni vidën në shulin e kapëses së tubit derisa të mbetet një hapësirë prej vetëm pak milimetrash midis diafragmës (A4) dhe kapëses së tubit (A6).

Vendosni dhe poziciononi kompresorin (A19) poshtë shulit të kapëses (shiko Fig. 12).

Shtërëngoni vidën e shulit duke përdorur një mjet të përshtatshëm. Mbani parasysh forcat e shtërëngimit.

11. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në boshtin e aktuatorit (A7).
12. Kapni kasën e sipërme të diafragmës (A1) me pjesën e hapur të drejtuar lart në një fiksion të përshtatshëm.
13. Vendosni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma e re (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) me boshtin e aktuatorit të drejtuar lart në kasën e diafragmës (A1).
14. Vendosni sustat (A10) në pllakën e diafragmës (A5) duke i qendëruar në pjesët e futura përkatëse.
15. Drejtoni me kujdes kasën e poshtme të diafragmës (A2) mbi boshtin e aktuatorit

(A7) dhe vendoseni mbi susta (A10).

Sigurohuni që elementët e izolimit të mos dëmtohen. Sigurohuni që lidhjet e ajrit të kompresuar në kasa (A1, A2) të pozicionohen saktë me njëra tjetrën.

16. Shtërëngoni kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës (A1, A2) së bashku duke përdorur dadot (A21) dhe bulonat (A20). Mbani parasysh forcat e shtërëngimit.
17. Montoni aktuatorin në valvul (shiko pjesën 5.1).

7.2 Ndërrimi i gominave të boshtit të aktuatorit

Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit zgjatet" (FA)

1. Ngrijeni aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
2. Zhvidhosni dadot (A21) dhe bulonat (A20) në kasën e diafragmës.
3. Lironi kompresionin e sustës së aktuatorëve me sustat e shtypura paraprakisht (shiko pjesën 9.3).
4. Ngrijeni kasën e sipërme të diafragmës (A1) dhe hiqni sustat (A10).
5. Tërhiqni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) nga kasa e poshtme e diafragmës (A2).
6. Përdorni një goditje të përshtatshme për të hequr gominën radiale të boshtit (A40).
7. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në gominë në re radiale të boshtit (A40).

8. Përdorni një mandrelë të përshtatshme për të montuar gominën radiale të boshtit (A40).
9. Ndërroni kushinetën e thatë (A42) dhe fshirësen (A41) nëse është e nevojshme.
10. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në boshtin e aktuatorit (A7).
11. Vendosni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma e re (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) në kasën e poshtme të diafragmës (A2). Sigurohuni që elementët e izolimit të mos dëmtohen. Sigurohuni që lidhjet e ajrit të kompresuar në kasat (A1, A2) të jenë pozicionuar mirë me njëra tjetrën.
12. Vendosni sustat (A10) në kasën e poshtme të diafragmës duke i qendërzuar në vendet e futura të posaçme.
13. Vendoseni sipër kasës së sipërme të diafragmës (A1).
14. Nëse është e nevojshme, shtypni sustat paraprakisht (shiko pjesën 5.2).
15. Shtrëngoni kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës (A1, A2) së bashku duke përdorur dadot (A21) dhe bulonat (A20). Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.
16. Montoni aktuatorin në valvul (shiko pjesën 5.1).

Versioni me drejtimin e veprimit "boshti i aktuatorit tërhiqet" (FE)

1. Ngrijeni aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
2. Zhvidhosni dadot (A21) dhe bulonat (A20) në kasën e diafragmës.




Fig. 14: Gominat e boshtit të aktuatorit

3. Ngrijeni kasën e sipërme të diafragmës (A1).
4. Tërhiqeni pjesën e pllakës së diafragmës që përbëhet nga pllaka e diafragmës (A5), diafragma (A4) dhe boshti i aktuatorit (A7) nga aktuatori.
5. Nxirrini sustat (A10) nga kasa e poshtme e diafragmës (A2).
6. Përdorni një goditje të përshtatshme për të hequr gominën radiale të boshtit.
7. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në gominë në re radiale të boshtit (A40).
8. Përdorni një mandrelë të përshtatshme për të montuar gominën radiale të boshtit (A40).
9. Ndërroni kushinetën e thatë (A42) dhe fshirësen (A41) nëse është e nevojshme.
10. Aplikoni një lubrifikant të përshtatshëm në boshtin e aktuatorit (A7).
11. Kapni kasën e sipërme të diafragmës (A1) me pjesën e hapur të drejtuar lart në një fiksime të përshtatshme.
12. Vendoseni pjesën e pllakës së diafragmës së bashku me boshtin e aktuatorit (A7) të drejtuar lart në kasën e diafragmës (A1).
13. Vendosni sustat (A10) në pllakën e diafragmës (A5) duke i qendëruar në pjesët e futura përkatëse.
14. Drejtoni me kujdes kasën e poshtme të diafragmës (A2) mbi boshtin e aktuatorit (A7) dhe vendoseni mbi susta (A10). Sigurohuni që elementët e izolimit të mos dëmtohen. Sigurohuni që lidhjet e ajrit të

kompresuar në kasa (A1, A2) të pozicionohen saktë me njëra tjetrën.

15. Shtrëngoni kasat e sipërme dhe të poshtme të diafragmës (A1, A2) së bashku duke përdorur dadot (A21) dhe bulonat (A20). Mbani parasysh forcat e shtrëngimit.

16. Montoni aktuatorin në valvul (shiko pjesën 5.1).

7.3 Përgatitja për dërgesën e kthimit

Aktuatorët me defekt mund t'i kthehen SAMSON për riparim.

Veproni si më poshtë për t'ia kthyer valvulat SAMSON:

1. Nxirrni jashtë pune valvulën e kontrollit. Shiko dokumentacionin e shoqëruar të valvulës.
2. Ngrijeni aktuatorin nga valvula. Shiko pjesën 9.2.
3. Nëse është e nevojshme, lironi kompresionin e sustës (shiko pjesën 9.3).
4. Dërgojeni aktuatorin në filialin më të afërt të SAMSON. Filialet e SAMSON janë renditur në faqen tonë të internetit në ► www.samson.de > Contact.

7.4 Porositja e pjesëve të këmbimit dhe furnizimeve të operimit

Kontaktoni filialin më të afërt të SAMSON ose departamentin e shërbimit të pas shitjes të SAMSON për informacione mbi pjesët e këmbimit, lubrifikantët dhe mjetet.

Pjesët e këmbimit

Shikoni pjesën 10.2 për detaje mbi pjesët e këmbimit.

Lubrifikanti

Detaje mbi lubrifikantët e përshtatshëm mund të gjenden në dokumentin

► AB 0100.

Mjetet

Detaje mbi mjetet e përshtatshme mund të gjenden në dokumentin ► AB 0100.

8 Defektet

Në varësi të kushteve të operimit, kontrolloni aktuatorin në intervale të caktuara për të parandaluar defektet e mundshme para se të ndodhin. Operatorët mbajnë përgjegjësi për hartimin e një plani kontrolli.

Zgjidhja e problemeve

Defekti	Arsyet e mundshme	Veprimi i rekomanduar
Boshti i aktuatorit nuk lëviz sipas kërkesës.	Aktuatori është bllokuar.	Kontrollo shtesën. Zhblloko aktuatorin.
	Presion sinjali i pamjaftueshëm	Kontrollo presionin e sinjalit. Kontrollo linjën e presionit për rrjedhje.
	Presioni i sinjalit nuk është lidhur me dhomën e duhur të diafragmës.	Shiko pjesën 3.4.
Boshti i aktuatorit nuk godet në diapazonin e tij të plotë të lëvizjes.	Ndalesa e lëvizjes është aktive	Shiko pjesën 6.5.
	Presion sinjali i pamjaftueshëm	Kontrollo presionin e sinjalit. Kontrollo linjën e presionit për rrjedhje.
	Aksesorët e valvulës nuk janë vendosur si duhet.	Kontrolloni aktuatorin pa aksesorë valvule. Kontrolloni cilësimet e aksesorëve të valvulës.

9 Heqja nga puna dhe çmontimi

RREZIK

Rrezik i plasjes së aktuatorëve.

Aktuatorët janë në presion. Hapja e papërshtatshme mund të bëjë që komponentët e aktuatorit të plasin.

Para se të filloni punë në aktuator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të aktuatorit.

PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të sustave në tension.

Aktuatorët me susta të shtypura paraprakisht janë nën tension. Ato mund të dallohen nga tre bulona të gjatë që dalin nga fundi i aktuatorit.

Para se të filloni punë në aktuator, lironi kompresionin nga sustat e shtypura paraprakisht (shiko pjesën 9.3).

9.1 Heqja nga puna

Për të hequr nga puna aktuatorin për punë shërbimi dhe riparimi ose për ta çmontuar, veproni si më poshtë:

1. Nxirreni jashtë pune valvulën e kontrollit. Shiko dokumentacionin e shoqëruar të valvulës.
2. Shkëputni furnizimin e ajrit pneumatik për të hequr presionin në aktuator.

9.2 Heqja e aktuatorit nga valvula


1. Nxirreni jashtë pune valvulën e kontrollit. Shiko dokumentacionin e shoqëruar të valvulës.
2. Zhvidhosni kapëset e konektorit të boshtit (A26/27).
3. Lironi dadon bashkuese të boshtit (9) dhe dadon e bllokimit (10).
4. **Duke hequr aktuatorët me veprim "boshti tërhiqet" me/pa susta të shtypura paraprakisht:** për të liruar dadon unazë (A8), aplikoni rreth 50% presion sinjali për të hapur valvulën.
5. Zhvidhosni dadon unazë në kapakun e valvulës.
6. Shkëputni sinjalin e presionit përsëri.
7. Ndani aktuatorin nga valvula duke shkëputur dadon unazë.
8. Shtrengoni dadon e bllokimit dhe dadon bashkuese të boshtit në valvulë.

9.3 Lirimi i kompresionit të sustës në aktuator

1. Zhvidhosni dadot e shkurtra (A21) dhe bulonat (A20) në kasat e diafragmës (A1, A2).
2. Zhvidhosni dadot e gjata (A23) dhe bulonat (A22) në kasat e diafragmës njëjloj në drejtim tërthor.

9.4 Hedhja

- Zbatoni rregullat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për hedhjen e mbetjeve.
- Mos i hidhni komponentët, lubrifikantët dhe substancat e rrezikshme së bashku me mbetjet e tjera shtëpiake.



10 Shtojcë

10.1 Shërbimi pas shitjes

Kontaktoni shërbimin e pas shitjes të SAMSON për ndihmë në lidhje me shërbimin ose punën e riparimit ose kur ndodhin probleme ose defekte.

E-mail

Mund të kontaktoni departamentin e shërbimit pas shitjes në aftersaleservice@samson.de.

Adresa e SAMSON AG dhe filialeve të tij

Adresat e SAMSON AG, filialeve, përfaqësuesve dhe ambienteve të shërbimeve të tij në të gjithë botën mund të gjenden në faqen e internetit të SAMSON, në të gjitha kataloget e produkteve SAMSON ose në pjesën e pasme të këtyre udhëzimeve për montimin dhe operimin.


Specifikimet e nevojshme


Ju lutem paraqitni detajet e mëposhtme:

- Numri i porosisë dhe numri i pozicionit në porosi
- Tipi, numri i modelit, sipërfaqja e aktuatorit, lëvizja, drejtimi i veprimit dhe gama e punimit (p.sh. 0,2 deri në 1 bar) ose gama e operimit të aktuatorit.
- Përcaktimi i tipit të valvulës së montuar (nëse zbatohet)
- Vizatimi i instalimit

10.2 Pjesët e këmbimit

- | | |
|---------------------------------------|---|
| 1 Kasa e sipërme e diafragmës | 56 Dado hegzagon ¹⁾ |
| 2 Kasa e poshtme e diafragmës | 57 Dado bashkuese |
| 4 Diafragma | 58 Rondele |
| 5 Pllaka e diafragmës | 59 Skeleti |
| 6 Kapëse tubi | 60 Volant |
| 7 Boshti i aktuatorit | 61 Kunja |
| 8 Dado unaze | 62 Kunja |
| 9 Dado hegzagon | 63 Kunja me fileta |
| 10 Susta | 64 Vidë kapaku |
| 11 Susta | 65 Vidë hegzagon |
| 12 Susta | 66 Dado bllokimi |
| 15 Dado manikotë | 67 Unazë |
| 16 Tapa e shfryrjes | 68 Gominë gjilpërë aksiale |
| 19 Kompresori në kapësen e tubit (6) | 69 Rondele |
| 20 Bulon hegzagon | 70 Dado rregullimi |
| 21 Dado hegzagon | 73 Kapaku |
| 22 Bulon hegzagon (shtypje paraprake) | 74 Dado bllokimi |
| 23 Dado hegzagon (shtypje paraprake) | 75 Kasa e sipërme e diafragmës |
| 24 Tapë vidë | 76 Gomina e boshtit radial |
| 25 Rondele | 77 Kushinetë e thatë |
| 26/27 Kllapa e konektorit të boshtit | 100 Etiketa e të dhënave |
| 28 Kapëse me kllapë | 101 Etiketa (shtypje paraprakisht) |
| 29 Bulon hegzagon | 106 Kunjë me fole |
| 30 Dado hegzagon | |
| 32 Varëse | 1) Vetëm për versionin me sipërfaqe aktuatori
240 cm ² |
| 40 Gomina e boshtit radial | 2) Zëvendoson dadon manikotë (15) në versionin
me ndalesë lëvizjeje ose volant |
| 41 Fshirëse | |
| 42 Kushinetë e thatë | |
| 43 Vidë hegzagon për varëse (32) | |
| 49 Fshirëse ¹⁾ | |
| 50 Sipër boshtit të aktuatorit | |
| 51 Konektori i boshtit | |
| 52 Flanxhë e vidhosur | |
| 54 Unazë | |
| 55 Tregues | |







SAMSON AG · MESS- UND REGELTECHNIK
Weismüllerstraße 3 · 60314 Frankfurt am Main, Germany
Phone: +49 69 4009-0 · Fax: +49 69 4009-1507
samson@samson.de · www.samson.de

EB 8310-6 SQ

2017-08-30 · English